
Kronikë

Lëvizte me pistoletë dhe municion në makinë, arrestohet 20-vjeçari në Tiranë! Dy familjarët kundërshtojnë policinë gjatë kontrollit të banesës (VIDEO+EMRI)

Një 20-vjeçar është arrestuar në Tiranë, pasi u kap duke lëvizur me një armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak në automjet. Dy familjarë të tij janë proceduar penalisht pasi kundërshtuan efektivët gjatë kontrollit të banesës.



Redaksia
3 Nëntor, 14:45 | **Përditësimi: 3 Nëntor, 15:10**

Share Post

Një 20-vjeçar ka përfunduar në prangat e policisë në Tiranë, pasi gjatë një kontrolli në makinën me të cilën udhëtonte iu gjetën një pistoletë dhe municion luftarak.

I arrestuari është Saverjo Daci banues në kryeqytet, i cili u ndalua nga efektivët e Komisariatit Nr. 3 në rrugën "Kastriotët", pas informacioneve të siguruara nga policia.

Gjatë kontrollit të automjetit, efektivët zbuluan armën e zjarrit dhe municionin, të cilat u sekuestruan si prova materiale.



LEXO EDHE:
I dënuar për vjedhje me armë e dhunë, arrestohet në Vorë 41-vjeçari i rrezikshëm! I gjendet armë zjarri dhe jelek anti-plumb (EMRI)

Pas arrestimit të 20-vjeçarit, policia ushtroi kontroll edhe në banesën e tij, ku dy familjarë, A. D., 51 vjeç, dhe L. D., 23 vjeç, kundërshtuan punonjësit e policisë, duke tentuar të pengonin kontrollin.

Të dy u proceduan penalisht në gjendje të lirë, ndërsa materialet i kaluan Prokurorisë për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

U.D | U.D | Shqiptarja.com

TAG: Saverjo Daci | arme zjarri

Sa e vlerësoni këtë artikull?

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
3 Nëntor, 11:50
Cilin mbështesni në përplasjen politike që u hap?

Ramën | Vellajn | Asnjërin

Lajme të tjera



Plagoset me armë zjarri 22-vjeçari në Tiranë, shpallet në kërkim autori! Sherri i nisur për shkak të një borxhi të pashlyer (EMRAT)
28 Tetor, 10:05



Shkodër/ Këngëtari Taulant Hoti plagoset duke pirë kafe në lokal! Dy netë më parë performoi live (VIDEO)
27 Tetor, 11:01



Lëvizte me 4 armë pa leje në makinë, arrestohet 40-vjeçari në Vlorë! Nën hetim edhe shoqëruesi i tij, sekuestrohen 16 fishekë
18 Tetor, 12:26



Me kallashnikov e pistoletë në taksi drejt Maqedonisë së Veriut, 30-vjeçari kapet në Dibër! Armët dyshohet se i mori në Tufinë
18 Tetor, 10:56



Qëlloi me armë zjarri drejt një servisi në Kashar, pranga 30-vjeçarit! Në banesë iu gjet fenerinë e municionesh me atë të Policisë
17 Tetor, 15:47



SHBA/ Adoleshenti vret me armë zjarri 3 fëmijë dhe një mësues brenda një shkolle fillore, ekzekutohet nga një kalimtar i rastit
16 Tetor, 17:22



Gjirokastër/ Kishte fshehur armë dhe kokainë në banesë, arrestohet 44-vjeçari! I dënuar më parë për vrasje (VIDEO)
16 Tetor, 10:10



Flogert Muça: Kur dështimi trashëgohet si armë
Flogert Muça
15 Tetor, 16:36



Kosovë/ Babai vret me armë zjarri të birin 29-vjeçar, arratiset nga vendngjarja
11 Tetor, 22:21



Gjermania kapet me armë pa leje në Kakavijë, 51-vjeçarja vihet në pranga! I sekuestrohet drogë (EMRI)
10 Tetor, 14:29



SHBA/ Të shtëna me armë zjarri në një banesë, humbin jetën 9 persona, mes tyre edhe fëmijë!
10 Tetor, 13:24



Interpol godet trafikun ndërkombëtar të armëve, 152 të arrestuar dhe mbi 2800 armë të sekuestruara! Zbulohen granata të trafikuara nga Bosnja në Serbi
9 Tetor, 18:02



Lajmi i fundit



4 milionë euro dëm! Joshnin viktimat me fitime fiktive, çmontohet skema e mashtrimit financiar, 7 në prangë! SPAK dhe Policia e Shtetit pjesë e operacionit ndërkombëtar
3 Nëntor, 15:20

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Lajmi i fundit



4 milionë euro dëm! Joshnin viktimat me fitime fiktive, çmontohet skema e mashtrimit financiar, 7 në pranga! SPAK dhe Policia e Shtetit pjesë e operacionit ndërkombëtar

3 Nëntor, 15:20